



AGJENCIA PËR PËRKRAHJE FINANCIARE NË BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL

Në bazë të nenit 7, alineja 9 të Ligjit për themelimin e Agjencisë për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare" e Republikës së Maqedonisë nr. 72/2007, 5/2009 dhe 43/2014), Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural shpall

THIRRJE PUBLIKE nr. 03/2015 për dorëzimin e kërkesave për shfrytëzim të mjeteve nga Programi për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2015

I. LËNDA E SHPALLJES

Lëndë e kësaj shpalljeje është ndarja e përkrahjes financiare për masat në vijim:

Masa	Emri i masës	Shuma e mbështetjes për shpenzimet e pranueshme për shfrytëzues
131	Bashkimi ekonomik i ekonomive bujqësore për kryerje të përbashkët të veprimtarisë bujqësore	6.000.000 denarë
131.1	Themelimin dhe funksionimin e kooperativave bujqësore të regjistruara në Regjistrin e kooperativave bujqësore pranë MBPEU	
131.2	Organizim të aktiviteteve informative dhe promovuese për prodhimet bujqësore	
131.3	Ndihmë e premive për sigurim si lloj kompensimi të pjesës së shpenzimeve për sigurim edhe atë në shumë që nuk do të kalojë 70% të shpenzimit për sigurim të kapaciteteve prodhuese të kooperativës bujqësore me kapacitet të vogël dhe 80% për sigurim të kapaciteteve prodhuese të kooperativës bujqësore me kapacitet të madh, por jo më shumë se 3.000.000 denarë në nivel vjetor	
131.4	Investime për furnizim të mekanizmit bujqësor në shumë prej 90% nga vlera e përgjithshme e furnizimit	

II. TË DREJTË PËR SHFRYTËZIMIN E MJETEVE

Të drejtë për shfrytëzimin e mjeteve kanë subjektet në vijim, edhe atë për masat:

Subjektet	MASA 1
Kooperativë bujqësore e regjistruar në Regjistër të kooperativave bujqësore pranë MBPEU në pajtim me Ligjin për kooperativa bujqësore	Masa 131

III. SHUMA E PËRKRAHJES FINANCIARE

Përkrahja financiare për masën 131 nga Programi për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2015 mund të ndahet në dy këste nga vlera e shpenzimeve të lejuara të pranueshme.

Përkrahja nga Masa 131.1 për funksionim të kooperativave bujqësore paguhet në mënyrë kuartale.

Përkrahja nga Masa 131.2 për organizim të aktiviteteve informative dhe promovuese për prodhime bujqësore ndahet në shumë prej 100% nga shpenzimet e përgjithshme të pranueshme për realizimin e aktiviteteve të parapara në programin për punë të kooperativës bujqësore dhe mund të ndahet në dy këste

Përkrahja e ndarë financiare është e pakthyeshme.

IV. KUSHTET PËR SHFRYTËZIMIN E MJETEVE DHE DOKUMENTACIONI I CILI DUHET TË DORËZOHET

Kërkesat për masat veç e veç dorëzohen në origjinal.

Një kërkesë mund të dorëzojë një kërkesë vetëm për një masë. Një kërkesë mund të shtrojë më së shumti 2 kërkesa të veçanta për masa të ndryshme duke marrë parasysh edhe masat e tjera nga Programi për zhvillim rural për vitin 2015.

Kushtet të cilat duhet të plotësojnë kërkesit e mjeteve janë përcaktuar me:

- Programi për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2015 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 196/2014)

- Ligjin për bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 49/2010, 53/2011, 126/2012, 15/2013, 69/2013, 106/2013, 177/2014 dhe 25/2015),

- Ligjin për kooperativat bujqësore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 23/2013 dhe 51/2015)

- Rregulloren për kushtet më të përafërta plotësuese për mbështetje të masave për zhvillim rural, shpenzime të pranueshme dhe shkalla e përkrahjes për shpenzimet e pranueshme për shfrytëzues për masë të veçantë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 124/2011, 80/2013 dhe 72/2014),

- Rregulloren për kriteret më të përafërta për zgjedhje të shfrytëzuesve për masë për zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 124/2011 dhe 80/2013)

Kërkesit e përkrahjes financiare duhet të dorëzojnë Kërkesë të plotësuar në mënyrë të rregullt dhe të plotë për shfrytëzim të mjeteve për Masën 131 së bashku me dokumentacionin e nevojshëm të theksuar në Kërkesë Kërkesit të cilët i kanë plotësuar kushtet për shfrytëzim të mjeteve për masën 131 radhiten me pikë të përcaktuar në Rregulloren për kriteret më të përafërta për zgjedhje të shfrytëzuesve për masë për zhvillim rural.

Kërkesat me numër të njëjtë të pikëve do të radhiten sipas datës dhe kohës së dorëzimit të kërkesës.

Kërkesit për masën 131.1 (me përjashtim të shërbimeve të personave të tretë për kontabilitet dhe revizion dhe bruto pagesa të personave profesional) 131.2 dhe 131.4 nuk guxojnë të fillojnë me realizimin e investimit para nënshkrimit Marrëveshjes për bashkëfinansim me Agjencinë.

V. MARRJA E FORMULAREVE DHE UDHËZIMEVE

Formulari-Kërkesë për shfrytëzim të mjeteve së bashku me listën e dokumenteve të nevojshme dhe Udhëzimin për shfrytëzuesit mund të merret në ueb faqen e Agjencisë www.ipardpa.gov.mk, dhe në qendrat më të afërta rajonale ose nësitë e punës së Agjencisë për nxitje të zhvillimit në bujqësi çdo ditë pune prej ora 8:30 deri në ora 16:30.

Formularët e lartpërmendur mund të merren edhe drejtpërdrejtë në Agjenci në adresën:

**Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural,
Bul. "3-ta Makedonska Brigada" nr. 20
(ndërtesa e Makedonija Tabak blloku C)
1000 Shkup**

VI. MËNYRA E DORËZIMIT TË DOKUMENTEVE

Kërkesat e plotësuara për shfrytëzimin e mjeteve për masën 131 të Programit për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2015 së bashku me dokumentacionin e tërësishëm të nevojshëm dorëzohen në gjuhën maqedonase në zarf të mbyllur në të cilin në pjesën e parme në këndin e epërm të majtë qëndron shenja "MOS HAP", për shpalljen publike nr. 03/2015 dhe shënim të shifrës së masës për të cilën dorëzohet kërkesa. Kërkesa mund të dorëzohet me postë ose personalisht në sportelin e Agjencisë, në të kundërtën Agjencia nuk ndërmerr përgjegjësi për arrije të vonuar ose të pakompletuar në sportel ose për hapje të parakohshme të kërkesës.

Afatit përfundimtar për dorëzimin e kërkesave është 18.05.2015. Kërkesat e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.

Informata më të detajuara në kontakt telefonin (02) 3097-460 ose kontakt e-mail adresën: ipardpa.info@ipardpa.gov.mk dhe në ueb faqen: www.ipardpa.gov.mk.

Kontakt:

Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural, Sektori për miratim të projekteve dhe Sektori për lejim të pagesave.

Telefoni 02 3097 - 460, çdo ditë pune prej 08.30 deri në ora 16.30

E-mail: ipardpa.info@ipardpa.gov.mk



AGJENCIA PËR PËRKRAHJE FINANCIARE NË BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL